


14.07.2020



Furnizimi , Mirembajtja dhe servisimi i klimave			
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUHAREKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NË DORËZIM - PRIMLJENO - RECEIVED			
Nësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	351	29506	7

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKË
KONTRATË

KOMUNA SUHAREKË, të cilën e përfaqëson Mustafë Buzhala , zyrtar i zyrës së Prokurimit dhe menaxheri i kontratës i caktuar me Aktvendim nga ZKA dhe ne PMK (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë dhe

Model Group SH.P.K., Rr. Hakif Sheholli, 10000, Prishtinë me NUI: 811351080 të cilën e përfaqëson Verona Sekiraqa (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Titulli i kontrates:

Furnizimi , Mirembajtja dhe servisimi i klimave
me numër prokurimit: 624-20-2140-1-3-6/624-020-049-136

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizimi , Mirembajtja dhe servisimi i klimave**, sipas specifikimit te dhënë me dosje te Kuotimit te çmimeve të dhëna nga operatori ekonomik me dosjes të tenderit.
- 1.2 Kontrata fillon me datën e nënshkrimit 13.07.2020 dhe përfundon me datën: 12 /01/2021
- 1.3 Vendi i kryerjes se furnizimeve do te jete Komuna e Suharekës, sipas kërkesave te njësisë.
- 1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

¹ ZKA Zyrtari Kryesor Administrativ

¹ PMK Plani per Menaxhimin e Kontrates

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës është 5.298,00 euro (pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë euro).

3.2 Çmimi është i dhënë në euro ku janë të përfshira të gjitha taksat dhe tatimet e aplikuara Kosovë

3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro nga njësia e kërkesës.

Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesën në euro, sipas faturave të dorëzuara së bashku me raportin e nënshkruar nga Komisioni i pranimit të mallit dhe menaxheri i kontratës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1. OE do të garantoj Autoritetin Kontraktues se furnizimet do t'i kryej konform specifikimeve të dhëna me dosje të tenderit .

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë kryerjen e furnizimeve.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim ne pajtim me ligjet e Kosovës

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës*.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen *Shqip* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Numri kontaktues +38344557150 E-mail: modelgroup.info@gmail.com

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Mustafë Buzhala
Pozita:	Zyrtar i zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	14.07.2020

**Për ofruesin e shërbimeve:**


Emri:	Verona Sekiraqa
Pozita:	Përfaqësues
Nënshkrimi	
Data:	14.07.2020



esa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Furnizim, Mirëmbajtje dhe Servisim i Klimave					
Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Qmimi për njësi	Qmimi total
	Furnizim me Klima				
1	Furnizim me Kima 12000 BTU Vërejtje: Në këtë pozicion të përshihet edhe montim deri në finalizim .	komplet	10.00	240.00	€ 2,400.00
2	Mbushja me gaz e klimave 9000-12000 BTU	cope			
3	Mbushja me gaz e klimave 18000-24000BTU	cope	60.00	35.00	€ 2,100.00
4	Mbushja me gaz e klimave 48000BTU	cope	3.00	2.00	€ 6.00
5	Pastrimi i klimave, verifikimi i tyre para mbushjes për rrjedhje të gasit ose ndonje dëmtim eventual.	cope	1.00	2.00	€ 2.00
6	Zhvendosja e klimave nga një zyre në zyren tjetër. Vërejtje: Në këtë pozicion të përshihet të gjitha punët përcjellëse deri në finalizim.	komplet	64.00	10.00	€ 640.00
7	Gyp Bakri së bashku me izolim 9000-18000BTU Vërejtje: Në këtë pozicion të përshihet edhe montim deri në finalizim .	m'	10.00	5.00	€ 50.00
			50.00	2.00	€ 100.00
Gjithësej :					€ 5,298.00

Identifikasi i Operatorit Ekonomik	
i i Kompanise	Model group Sh.P.K.
isa e Plote	Rr. hakif sheholli
agesuar Nga:	



ri	verona sekiraga
ita	Drejlore
shkrimi	22.06.2020
a	
a	

